

NERTILA KËLLIÇI GOGA

METODA SHKENCORE FILOLOGJIKE E MARIO ROQUES NË TEKSTET E VJETRA SHQIPE

Jeta dhe veprimtaria e Mario Roku

Dijetari dhe gjuhëtari francez Mario Rok (Mario Roques), lindi më 1 korrik 1875 në Callao, në Peru, nga një baba, atashe në shërbimin diplomatik francez. Ai erdhi herët në Paris, ku ishte nxënës në Shkollën Normale Supérieure (1894 - 1897), në Shkollën Praktike të Studimeve të Larta (1894 - 1903), dhe në Shkollën Nacionale të Gjuhëve të Gjalla Lindore (1897 - 1900). I tërhequr më shumë nga gjuha rumune, Mario Roku qëndroi për një kohë të gjatë në Rumani. Në vitin 1901, ai u bë lektor i gramatikës historike të gjuhës frënge në Shkollën Normale Supérieure, dhe në të njëjtin vit, lektor edhe i latinishtes vulgare pranë Shkollës Praktike të Studimeve të Larta në Sorbonë, në seksionin e Shkencave Historike dhe Filologjike, ku u bë radhazi pedagog, Zëvendësdrejtor dhe Drejtor i Studimeve (në 1903), si dhe Kryetar i Seksionit të Shkencave Historike dhe Filologjike (në 1937). Në 1907, Mario Roku u bë profesor i gjuhës rumune në Shkollën Nacionale të Gjuhëve të Gjalla Lindore, dhe 5 vite më pas, u ngarkua me drejtimin e Institutit të Filologjisë Rumune në Fakultetin e Letërsisë. Gjithashtu, pranë Shkollës Nacionale të Gjuhëve të Gjalla Lindore, në 1919, filloi të jepte mësim të gjuhës shqipe.

Në 1937, Roku u bë profesor i Kolegjit të Francës, ndërsa në 1944, anëtar i Këshillit Administrativ të Qendrës Kombëtare të Kërkimit Shkencor, dhe dy vjet më vonë, anëtar edhe i Qendrës Universitare Mesdhetare dhe i Institutit të Studimeve Politike.

Që në vitin 1903, Mario Roku shfaqti interes për gjeografinë gjuhësore. Në 1912, ai bashkëpunoi me gjuhëtarin zviceran Jules Gilliéron për një vëllim mbi këtë temë. Po atë vit, ai mori drejtimin e revistës *Romania*, botoi edhe shumë artikuj në të, duke kryer detyrën e jashtëzakonshme të mbledhjes së kërkimeve më të mira në linguistikën dhe historinë letrare të Mesjetës. I pasionuar pas studimit të fjalorit francez, Roku publikoi, në vitet 1936-1938, dy volume të një Përmbledhje të Përgjithshme të Leksikut

të Frëngjishtes të Mesjetës (*Recueil general des lexiques français du Moyen Âge*)¹.

Mario Roku pati një karrierë të shkëlqyer akademike. Vdiq në Paris më 8 mars 1961.

Për Mario Rokun, filologjia ishte së pari, studimi kritik i fakteve, ku e vërteta shkencore gjendej tek detaji modest, i vëzhguar rigorozisht. Ja përse do të ishte i pamundur citimi i listës tërësore të publikimeve të tij, të cilat janë mbi 200 tituj. Studimet e filologut francez u përqendruan në çështje sa letrare aq dhe gjuhësore, të paraqitura që nga tekstet më të vjetra franceze, si tek *Betimet e Strasburgut* e deri tek Guillaume Apollinaire. Jashtë fushës franceze, Mario Roku u kujdes me raste për latinishten vulgare, për dialektin e vjetër francez, kryesisht atë provençal², për gjuhën rumune, atë shqipe, dhe madje, edhe për disa të folura sllave të Jugut.

Veprimtaria e frytshme e gjuhëtarit, bibliografit dhe folkloristit të palodhshëm Mario Rok, u ndikua nga zhvillimi i dukshëm i kërkimeve në fushën e filologjisë sidomos në fillimet e shekullit XX. Studiuesit gjuhësorë kishin filluar të bënin hulumtime të ndryshme shkencore, jo vetëm për të njohur historinë dhe origjinën e popujve më të lashtë, por dhe kulturën, gjuhën dhe letërsinë e tyre, përmes dokumenteve e teksteve të vjetra.

“Për Mario Rokun, filologjia shqiptare, domethënë njohja, leximi, interpretimi dhe përdorimi i teksteve shqipe, dorëshkrime ose të shtypura, ishte përkundrazi në fillimet e saj dhe kjo ishte për të ardhur keq, sepse, siç do të shprehej autori i saj, imazhi i gjendjeve gjuhësore të mëparshme të fiksuara në dokumentet e shkruara, sado i papërkryer që të jetë, ndihmon për të kuptuar gjuhën e gjallë; piketimet kronologjike që sjellin tekstet e vjetra janë një udhërrëfyes dhe një verifikim për rindërtimin e zhvillimit historik të një gjuhe”³.

Vepra e Mario Rokut: “Gjurmime mbi Tekstet e Vjetra Shqipe”, me tetë faksimile.

Vëllimi studimor shkencor “*Recherches sur les anciens textes albanais*”, avec huit fac-similés, (“Kërkime mbi tekste të vjetra shqipe”, me tetë faksimile) i botuar në Paris në vitin 1932, është përkthyer në shqip nga

¹ <http://www.arllfb.be/composition/membres/roques.html>

² Dialekt i rajonit juglindor të Francës, Provence.

³ S. Mancaku, M. Rok për filologjinë shqiptare, “Studime Shqiptare” 13, Shkodër, 2005, f. 13.

frëngjishtja, dhe pajisur me shënime plotësuese nga etnografi dhe bibliografi, studiuesi i njohur Vili Kamsi (Willy Kamsi), nën titullin “Gjurmime mbi Tekstet e Vjetra Shqipe”, me tetë faksimile⁴ dhe botuar në Shkodër, 2011. “Për herë të parë, pa mohue kontributin e veçantë e të pjesshëm të mëparshëm të gjurmuesve shqiptarë, studjuesi frëng Mario Roques bante një përpjekje organike për të paraqitë kjartë, kronologjikisht e sa më të plotë, si në pikëpamje tekstologjike dhe bibliografike, krejt një plejadë autorësh të vjetër”⁵.

Këtë vepër të rëndësishme për gjuhën shqipe vlerësoi në mënyrë të veçantë, gjuhëtari dhe albanologu i shquar E. Çabej, botimin e së cilës e pati konsideruar si një *Corpus* të dokumenteve dhe të teksteve të autorëve të vjetër të shqipes: “Në vitin 1932 Mario Roques, në një punim me rëndësi themelore për filologjinë shqiptare, dha një përshkrim e një karakteristikë të veprës, të bazuar në shqyrtime direkte të tekstit e në studime të imta të burimeve, dhe hodhi dritë aty edhe mbi literaturën e Shqipërisë Veriore të kohës pas Buzukut”⁶.

Vetë hartuesi i këtij vëllimi, gjurmuesi i dorëshkrimeve të vjetra, Mario Rok, për punën e kryer kërkimore e studimore, do të shprehej: “Gjurmimet e fillueme tash sa vjet më banë të rishqyrtoj tekstet e qituna tashmë në pah dhe më lejuen të zbuloj për disa sosh botime ose kësomblla të padijtuna; u gëzova kur gjeta tekste të reja, ndër të cilat një, së paku, me shumë randësi; më në fund, shqyrtimi i botimeve historike të lanuna tepër mbas dore dhe një hulumtim, të cilin do të kisha dashtë t’ishte më pak i vrullshëm, në arkivat e Romës, më kanë dhanë një grumbull njoftimesh, mbi veprimtarinë fetare në Shqipëri, në shekullin XVII, që më vjeftën me lëshue ndopak dritë mbi një çast të historisë ballkanike të njoftun mjaft keqas”⁷.

Në këtë vepër, historiani i gjuhës, Mario Rok, dha një inventar dhe përshkrim të detajuar të 17 teksteve të vjetra shqipe të shekujve XV-XVIII, duke filluar me “Formulën e Pagëzimit” dhe duke përfunduar me “Fjalorin italisht-shqip” të Grottaferrata-s. Në këtë punim, këto tekste do të paraqiten kronologjikisht, së bashku me disa shpjegime të autorit:

⁴ Publikuar fillimisht tek “Buletini Shkencor i Institutit pedagogjik dyvjeçar të Shkodrës” në vitin 1964, numër i posaçëm, f. 385-409 dhe 1965, f. 397-422.

⁵ W. Kamsi, *Gjurmime mbi Tekstet e Vjetra Shqipe e shkrime të tjera*, Hymje, f. 5.

⁶ *Studime gjuhësore*, VI, Prishtinë, 1977.

⁷ Përkthyer nga Willy Kamsi, *Gjurmime mbi Tekstet e Vjetra Shqipe e shkrime të tjera*, f. 24.

1. Formula e pagëzimit, sipas ritit roman, 1462, dorëshkrim, me ripordhim fotografik, për të cilën albanologu Mario Rok do të tregonte: “Kjo formulë e shkurtër është pjesë e *Constitutiones* të lexuar prej Kryepeshkvit të Durrësit, Pal Engjëllit “*in Ecclesia sancte Trinitatis de Emathia*”, në 8 nëntor 1462, për të ndrequr shpërdorimet e vërtetuara gjatë një vizite baritore”⁸.

Më parë, në dy numra të revistës “Romania”⁹ të vitit 1926, Mario Roku kishte analizuar dokumentin e parë të gjuhës shqipe “Formulën e Pagëzimit” të Pal Engjëllit, të zbuluar nga historiani rumun Nikola Jorga në një nga bibliotekat e Milanos, në Itali, në 1915-ën.

2. Fjalori i vogël i Arnold von Harff-i, 1496, dorëshkrim. Mario Roku shqyrtoi listën e fjalëve të shkrimtarit dhe gjuhëtarit gjerman Arnold von Harff-i në fjalorthin shqip-gjermanisht prej 26 fjalësh, në të cilin gjendeshin gjithashtu 8 formula të shkurtra ose fjali, dhe emra të numrave (1-10, 100, 1000) të mbledhura prej tij ndërmjet Ulqinit dhe Durrësit. Në këtë fjalorth, studiuesi francez dalloj 46 unitete leksikore.

“*Fon Harfi përdori mbi shqipen drejtshkrimin e tij gjerman, i cili natyrisht nuk mund të mbante parasysh e të respektonte fonemat e shqipes që ndryshojnë nga ato të gjermanishtes*”¹⁰.

3. Ungjilli i Mënatës së Pashkëve dhe tropari i Pashkëve, sipas ritit bizantin, dorëshkrim. Njihet si “Perikopeja e Ungjillit të Pashkëve”. Paleografi Rok shpjegonte se ky dorëshkrim gjendej në formën e një flete katrore, që dukej se ishte gjysma e poshtme e një flete, që në pjesën e sipërme kishte pasur shkrime të tjera. Në pjesën e parme të fletës ishte përkthimi në shqip i vargjeve 62-66 të kapitullit XXVII të Ungjillit sipas Shën Mateut, i paraprirë nga një titull në greqisht dhe i mbyllur me formulën e të përshëndeturit të korit që i drejtohej Ipeshkvit. Në anën e mbrapme të fletës kishte nota muzikore me fjalë greke të shkruara nën secilin rresht. Rreshti i parë i notave ishte zhdukur thuajse krejtësisht kur e kishin prerë fletën më dysh; në vijim të pjesës me nota, ishte teksti greqisht dhe përkthimi shqip i troparit të Pashkëve.

Sipas hulumtuesit Roku, këto dy tekste të vogla, të shkruara me shkronja greke dhe të kthyera në trajtat shqipe, përmbanin fjalë të shqipes jugore, siç e tregonin trajtat me rotacizëm *ουρδουρω* = *urdhuro* (geg.

⁸ Po aty, f. 26.

⁹ “Romania”, janar-prill 1926, f. 162 dhe f. 504.

¹⁰ R. Elsie, *Histori e Letërsisë Shqiptare*, përkthyer nga origjinali anglisht “History of Albanian Literature” (1995), nga Abdurrahim Myftiu, Tiranë, 1997, f. 26.

urdhënoj “ordinare”), *σευδέκουρ* = së vdekur dhe *σευδέκουριτ* = së vdekurit (geg. *vdekun*, pjesore e shkueme e *vdes* “mourir”)¹¹.

Sa i përket periudhës kohore të shkrimit të teksteve, Roku vuri në dukje se për këtë çështje i ishte drejtuar paleografëve, Imzot Mercati-t, Prefekt i Bibliotekës Vatikane në Romë, z. H. Omont-i, ruajtës i Dorëshkrimeve në Bibliotekën Kombëtare të Parisit dhe Imzot Galbiati-t të Milanos, përfundimet e të cilëve përkuan duke nxjerrë konkluzionin se dorëshkrimi mund të ishte i gjysmës së dytë apo fundit të shek. XV, ose ndoshta i fillimit të shek. XVI¹².

4. Libri i orëve dhe meshari, përkthyer nga Gjon Buzuku, shtypur 1554-1555. Njohësi i mirë i paleografisë, Roku tregonte se vëllimi kishte 100 fletë, nga të cilat 94 fletë ishin tekst; ishte shtypur me fletë dyshe, me filigramë të ndryshëm dhe që kishte si shënjim, serinë alfabetike latine të plotësuar me disa shkronja jo-latine, përzierje që binte në sy edhe në tekst. Libri i Gjon Buzukut ishte i radhitur me shkronja latine, të një tipi gjysmë gotik, dhe veçonte pesë shkronjat që për të ishin me zanafillë tjetër, ndër to: shkronja *γ* e alfabetit cirilik, shkronja *з* e alfabetit cirilik dhe latin të kohës, shkronja *λ* me zanafillë boshnjake. Duke iu referuar Bibliotekës Kombëtare të Parisit, e cila kishte një kësombëll të një libri orësh me cirilike boshnjake, të shtypur në vitin 1512 në Venedik, Roku vuri në dukje se dëshira e Buzukut për t’u dhënë bashkatdhetarëve një libër orësh të hartuar në gjuhën kombëtare, ishte me rëndësi për historinë e përdorimit liturgjik të gjuhëve kombëtare në Kishën katolike. Librat e orëve të viteve 1512-1571 përfshinin disa elementë që nuk gjendeshin tek Buzuku, por për Rokun ky material kishte mjaft vlerë, mjaftonte që ai të kishte dashur t’u jepte bashkatdhetarëve të vet një libër të ngjashëm me ata që shihte në duart e sllavëve katolikë. Libri i Buzukut që përfshinte elementët e parë të librit të orëve: Oficja e vogël e Virgjinës, Psalmet pendestare, Litanitë, Përshpirtjet, si dhe fundin, që ishte thujse tre të katërtat e librit, dhe që përmbante Mesharin, nuk kishte ndonjë shembull të ngjashëm që të kishte shërbyer si model, - vërente Roku¹³. Për të, Gjon Buzuku kishte punuar nën ndikimin e një frymëzimi françeskan, ndoshta sipas ndonjë modeli françeskan të ngjashëm me librat e orëve boshnjakë të 1512-ës. Ai ishte një përfaqësues i Shqipërisë mesjetare, i prekur prej ndikimeve venedikase, me elementë romakë të gjuhës, duke luajtur një rol me rëndësi në ngulitjen

¹¹ *Gjurmime mbi Tekstet e Vjetra Shqipe e shkrime të tjera*, f. 27.

¹² Po aty, f. 29.

¹³ Po aty, f. 36.

e grafisë shqipe. Tek autorët e mëvonshëm, Budi, Bardhi, Bogdani gjendeshin shenja jolatine të vendosura më parë nga Buzuku, si: **γ**, **ε** dhe **з**, ku kishte shumë mundësi që Budi të ishte njohur me këtë libër të Buzukut, dhe t'i kishte marrë hua këta elementë të sistemit të tij grafik, “po të hamendësojmë se njëri apo tjetri të kenë qenë, në mënyrë të pavarur, trashëgimtarët e një tradite krahinore grafike të shqipes”¹⁴.

Prof. Çabej pranon mendimet e dijetarit francez, veçanërisht për vlerën e sibilantit të zëshëm **z**, që mund të jetë edhe shkronjë cirilike e kthyer nga e djathta, e po kështu “Për ndonjë fjalë të shkruar me **u**, siç janë *shqyt* e *magjyp*, për Veri vërtetohen të dyja trajtat, dhe dëshmitë e autorëve të vjetër janë kundërthënëse”¹⁵.

5. Katekizmi i Atit Ledesma përkthyer nga Lekë Matrënga (Luca Magtranga), dorëshkrim dhe shtypshkrim, 1592, në Bibliotekën e Vatikanit, *Vaticana R. G Teologia V*, 1265, e njohur si “E mbësuar e krishterë” (“Doktrina e Krishterë”). Në kopjen e shtypur, titulli kishte ndryshime të vogla me atë të kopjeve të dorëshkruara, dhe po kështu dhe në tekst, megjithëse për këtë të fundit, Roku thoshte se nuk kishte mundur ta krahasonte. Por ndryshimi më serioz për të, ishte mungesa e shkronjave të theksuara, pasi përkthyesi Matrënga kishte hequr dorë nga ruajtja në shtyp e theksit, ndërsa kishte ruajtur formën **œ** që ishte ruajtur për një kohë të gjatë tek Arbëreshët e Italisë, dhe që në shqip i korrespondonte zanorja **ë**. Sipas Rokut, grafia e priftit arbëresh, Matrënga, ishte krejt e pavarur nga ajo e Buzukut, dhe për herë të parë ai jepte shembuj të përdorimit të **th**-së për fshikulluesen ndërthembore të shurdhër, që shqipja do ta përgjithësonte vetëm në shekullin XIX.

Kopja në dorëshkrim e Matrëngës, këtij katekizmi prej njëzetetë faqesh, përkthyer nga një vepër latinisht e priftit jezuit spanjoll Jakob Ledesma (1516-1575), që kishte ardhur deri në ditët tona në tri variante të ndryshme, i pari nga të cilët ishte me sa duket me shkrimin e vetë Matrëngës, ishte kataloguar nën *Codex Barberini Latini 3454* në Bibliotekën e Vatikanit. Nga data e shënuar në variantin e parë, Matrënga e kishte përfunduar përkthimin e tij më 20 mars 1592, në Piana dei Greci.

¹⁴ Po aty, f. 41.

¹⁵ D. Luka, P. Kotri, *M. Rok – një ndër themelvënësit e kërkimit dhe të studimit të burimeve arkivore për gjuhën shqipe*, “Studime shqiptare” 13, Shkodër, 2005, f. 30.

Varianti i botuar, nga i cili ka shpëtuar vetëm një kopje, u shtyp në Romë nga Gulielm Façoti (Guglielmo Facciotto)¹⁶.

6. Mbishkrime në Piana dei Greci (sot Piana degli Albanesi). Mario Roku shkruante se në Kishën e Shën Mitrit të Piana dei Greci kishte katër mbishkrime moralizuese shumë të shkurtra, në njërën prej të cilave ishte shënuar viti 1606. Tingulli *ē* ishte shënjuar me *γ* në njërin nga tekstet, ndërsa në dy mbishkrimet e tjera shfaqej me *æ*, si tek Lekë Matrënga.

Mendohet se këto mbishkrime shqipe në Kishën San Demetrio të Horës së Arbëreshëve, që i përkasin fillimit të shekullit XVII, të jenë të humbura nga rrënojat e kohës¹⁷.

7. Katekizmi i Bellarmino-s i përkthyer nga Pjetër Budi (Pietro Budi), i shtypur në Romë, 1618. Kjo ishte vepra e parë e Budit, e quajtur “*Dottrina Christiana*” ose “*Doktrina e Kërshtenë*”, një përkthim i katekizmit të Shën Robert Belarminit (Roberto Bellarmino, 1542-1621). U botua për herë të parë në Romë më 1618. Paleografi i palodhur francez gjeti ekzemplarë të tjerë të botuar në vitet: 1636, 1664, 1868.

Një kopje origjinale e kësaj vepre ruhet në Bibliotekën e Vatikanit (R.I. VI. 449).

8. Rituale Romanum (Rituali roman) me rubrika shqip, i shtypur në Romë, 1621. Në këtë ritual, Mario Roku vuri re se lutjet dhe formulat ishin në latinisht, ndërsa rubrikat dhe komentet, disa prej të cilave të shtjelluara gjerësisht, ishin në shqip.

9. Speculum confessionis (Shpjegimi i meshës romane).

Ky fashikull shpjegues i meshës romane është shtypur si plotësim i Ritualit, megjithatë studiuesi francez Rok e konsideroi atë si një vepër të vogël më vete.

Mario Rokut i atribuohet gjetja e dy veprave të mësipërme “Rituali roman” dhe “Shpjegim i meshës romane”.

10. Speculum confessionis¹⁸, i shtypur në Romë, 1621. Njihet si “*Pasqyra e t’rrëfyemit*”, përkthyer nga Pjetër Budi. Paleografi Rok bëri të ditur se ekzistonin tre ekzemplarë të ‘pasqyrës’.

Për filologun dhe bibliografin francez, veprat e mësipërme të Pjetër Budit (nga 7-10) ishin, jo vetëm vepra që kishin shërbyer për një kohë të gjatë për edukimin e klerit shqiptar, por përbënin një lëndë të rëndësishme

¹⁶ R. Elsie, *Histori e Letërsisë Shqiptare*, përkthyer nga origjinali anglisht “History of Albanian Literature” (1995), nga Abdurrahim Myftiu, Tiranë, 1997, f. 31.

¹⁷ A. Marashi, *Mario Rok (M. Roques) dhe studimi i teksteve të vjetra shqipe*, “Studime shqiptare” 13, Shkodër, 2005, f. 92.

¹⁸ Përkthyer nga Specchio di confessione të Atit Emerio de Bonis.

për studimin e shqipes. Vepra përmbante 800 faqe përkthim ose përshtatje, nga 50 faqe prozë origjinale, më se 60 poezi, që jepnin njoftime për gjuhën e Shqiptarëve të Veriut nën ndikimin e shekullit XVI¹⁹.

Mario Roku vlerësoi punën e klerikut Budi, veprimtarinë metodike në tërësinë e përkthimeve të tij, “*kujdesjet intelektuale në poezitë e tij dhe në të shtypurit e tyre*”, atdhedashurinë e tij, që nuk e kishte menduar të humbur çështjen e krishtërit në Shqipëri pas fitores turke dhe që kishte dhënë ndihmesën e vet për të ruajtur të gjalla disa shkëndija të ndjesisë kombëtare²⁰.

11. Leksik i vogël etimologjik i Pjetër Mazrekut (“Petit lexique étimologique”, Pietro Maserecco), dorëshkrim, 1632. Ky dokument ishte një relacion i Kryepeshkvit të Tivarit, Pjetër Mazreku, kumtuar Propagandës në Kongregacionin fetar klerik të atij viti.

Edhe gjetja e kësaj vepre i atribuohet historianit të gjuhës, Mario Rok.

12. Dictionarium latino-epiroticum i Frang Bardhit (Franciscus Blancus), i shtypur në Romë, 1635.

Në veprën e tij mbi tekstet e vjetra shqipe, studiuesi francez, Mario Rok, bëri një ribotim të plotë të këtij fjalori, të pajisur me hyrje dhe shënime të vetat mjaft të vlefshme, të cilat u kanë shërbyer të gjitha studimeve të deritanishme lidhur me të.

12^{bis}. Fjalori italisht – shqip i At Xhuzepe Iccaran (Giuseppe Iccaran), dorëshkrim, 1644.

“*Mbas botimit të kësaj kujtese, m’është njoftue prej bibliotekarit të qytetit të Reims-it, të cilin e falënderoj për njoftimin e tij të mirësjellshëm, se kjo depo zotnon një kësombëll të Doktrinës së krishtenë të Budit të 1636, që do t’i shtohet 5 kësombllave që kam tregue vetë. Jam i bindun edhe më shumë se fjalori i Iccaran-it, vjetërsia e të cilit m’është dukë e dyshimtë, është në të vërtetë një vepër shumë moderne*”²¹. Nuk dihet nëse Mario Roku e ka parë nga afër këtë fjalor, megjithatë ky dokument do të ishte një thesar tjetër i gjuhës shqipe të mesit të shek. XVII.

13. Doctrina Christiana e Bellarminit, (Doktrina e Kërshtenë e Belarminit), përkthyer nga **Bernardo da Quinzano** (da Verona), i shtypur, 1675. Françeskani Bernardo da Quinzano kishte qenë misionar në Shqipëri në periudhën 1636-1649, ku kishte mësuar mirë gjuhën shqipe, dhe në

¹⁹ *Gjurmime mbi Tekstet e Vjetra Shqipe e shkrime të tjera*, f. 57.

²⁰ Po aty, f. 61.

²¹ Po aty, f. 65, përkth. Willy Kamsi.

vitin 1675 shtypi në Venedik një përkthim shqip të Katekizmit të Belarminit.

Mario Roku do të deklaronte se nuk e kishte gjetur dot këtë doktrinë të vogël, megjithëse ishte shtypur dy herë. Nuk kishte gjetur gjurmë të tij as në Paris, Londër, Romë e as në Venedik.

14. Cuneus Prophetarum i Pjetër Bogdanit, i shtypur, 1685. Ky dokument njihet si “Çeta e Profetëve”. Gjuhëtari Mario Rok shpjegonte se *Cuneus*-i ishte një letër e Bogdanit drejtuar Propagandës, kumtuar në Kongregacionin e përgjithshëm të 25 qershorit 1675. Ai bënte me dije për dy ribotime të tjera të kësaj vepre, “*të cilat nuk duhen vështruar si pseudo-botime, siç është gjykuar ndonjëherë*”²².

15. Fjalori shqip - italisht e italisht - shqip i Nilo Katalanos (Nilo Catalano), dorëshkrim, 1694. Sipas Rokut, këtë dorëshkrim e zotëronte Zef Skiroi, sipas të cilit Katalano, megjithëse italian e jo shqiptar, e kishte hartuar këtë fjalor në gegërishte dhe jo në toskërishte të Himarës apo shqipe të Italisë.

16. Fjalori shqip i At Françesko Maria da Leçes (Francesco Maria da Lecce), dorëshkrim, 1702. Ky fjalor i At Francesço Maria da Leçes, i françeskanit që kishte qenë misionar në Shqipëri, konsiderohej i humbur, megjithëse gjendeshin pjesë të studiuara nga Dhimitër Kamarda. Por në vitin 1991 u gjet nga Jup Kastrati *parathënia* në shqip e tij, e shkruar, sipas këtij studiuesi, nga vetë dora e Da Leçes²³.

17. Fjalori italisht – shqip i Grottaferrata-s, dorëshkrim, 1710. Mario Roku kishte mundur ta shihte këtë fjalor, këtë dorëshkrim të gramatikës së parë të shqipes, në Bibliotekën e Manastirit të Grottaferratës, afër Romës, falë ndihmës së studiuesit dhe teologut arbëresh, Nilo Borxhia (Nilo Borgia). Fjalori ishte një përmbledhje e vogël, që përfshinte në pjesën e parë një fjalor dhe një gramatikë shqipe, të shoqëruar me shembuj, me lutje dhe elementë katekizmi me përkthim në shqip²⁴.

Vlerat shkencore gjuhësore të veprës së Mario Rokut

Filologjia shqiptare, që në fillimet e saj, është e lidhur ngushtë me emrat e disa studiuesve francezë. Dhe padyshim, ndër filologët e

²² D. Luka, P. Kotri, *M. Rok – një ndër themelvënësit e kërkimit dhe të studimit të burimeve arkivore për gjuhën shqipe*, “Studime shqiptare” 13, Shkodër, 2005, f. 30.

²³ A. Marashi, *Mario Rok (M. Roques) dhe studimi i teksteve të vjetra shqipe*, “Studime shqiptare” 13, Shkodër, 2005, f. 94.

²⁴ “Gjurmime mbi Tekstet e Vjetra Shqipe e shkrime të tjera”, f. 70.

albanologët më të shquar në drejtim të studimit të teksteve të vjetra në gjuhën shqipe, është Mario Roku.

Paleografi francez ndoqi një drejtim të ri kërkimesh në fushën e studimit të teksteve të vjetra shqipe, duke u bërë një ndër kontribuesit kryesorë në krijimin e një tradite të vërtetë shkencore. “*Kërkimet më pasionante të tij lidhen me filologjinë, e kuptuar kjo si art i leximit, i interpretimit dhe studimit kritik të teksteve të vjetra me metoda të rrepta shkencore si ato të shkencave ekzakte, duke vlerësuar edhe faktet më të vogla dhe duke u bërë thirrje disiplinave të tjera, historisë së letërsisë së krahësuar, traditave popullore për të zbuluar përmes tyre tipare të jetës njerëzore, diçka nga mendja dhe shpirti i njerëzve*”²⁵.

Përveç shqyrtimit dhe analizimit të teksteve shqip të zbuluar më parë, dijetari francez, Mario Rok, solli dokumente shqip të panjohura deri në atë kohë. Përkushtimi i jashtëzakonshëm i gjuhëtarit të shquar në gjetjen dhe studimin shkencor të këtyre dokumenteve të rëndësishme, përgjatë shekujve XV – XVIII, nëpër arkivat dhe bibliotekat e Italisë dhe me ndihmën e bibliotekarëve dhe paleografëve, ngriti një monument të fuqishëm të historisë së gjuhës shqipe.

Vepra shkencore gjuhësore “*Recherches sur les anciens textes albanais*” i Mario Rokut është fryt i kërkimeve dhe hulumtimeve shumëvjeçare të imtësishme dhe këmbëngulëse të tij, si dhe testament i pazëvendësueshëm i dokumentimit me metoda shkencore filologjike të teksteve të vjetra shqipe.

BIBLIOGRAFI

- Çabej, E., Studime gjuhësore VI, *Gjon Buzuku dhe gjuha e tij*, “Rilindja”, Prishtinë, 1977.
- Kamsi, W., *Mario, Roques. Gjurmime mbi Tekstet e Vjetra Shqipe, me tetë faksimile* Botime Françeskane, Shkodër, 2011.
- Myftiu, A., *Robert Elsie. Histori e Letërsisë Shqiptare*, Tiranë, 1997.
- Studime shqiptare 13, *Dijetarët francezë për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare*, Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Sektori shkencor i Albanologjisë, Shkodër, 2005.

²⁵ S. Mancaku, *M. Rok për filologjinë shqiptare*, “Studime Shqiptare” 13, Shkodër, 2005, f. 12.